



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 535 Prot.

Tiranë, më datë 19.02.2020

**VENDIM**

**Nr. 56, datë 19.02.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134 dhe V.K.M Nr.208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit dhe raportit të gërmimit arkeologjik, në Këshillin Teknik të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.02.2020,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë projektin “Rikonstrukcion dhe fuqizim i segmentit të linjës 35 Kv TEC/Fier Hoxharë” dhe raportin arkeologjik të shpëtimit në zonën e shtyllës nr. 48 pranë N/S 35 kV Pojan nga subjekt i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani;
2. Gjetjet e zbuluara të depozitohen pranë fondeve të IA, në Parkun Arkeologjik të Apolonisë pasi të jenë rregjistruar më parë në IKRTK;
3. Të vijojnë punimet e zbatimit për ndërtimin e shtyllës nr. 48;
4. Të kryhen sondazhe arkeologjike për shtyllat nr. 49, 50 nga subjekt i licencuar në arkeologji duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe, me IKTK i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
5. Të realizohet vëzhgimi arkeologjik sipërfaqësor për shtyllat nr. 1 – 48 dhe 50-92 pranë N/S Hoxharë” nga subjekt i licencuar në arkeologji;
6. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

**KRYETAR**

**Elva MARGARITI**

